



Fakulteti / Departamenti: Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit

Lënda: Ligjërata # Evidentimi i pikëve në tenis

Mënyra e llogaritjes së pikëve në tenis habit shumë njerëz përreth. Shumica thonë si është e mundur që për një pikë të fituar ti fitosh 15 pikë për një pikë të fituar.

Sidoqoftë, sistemi i pikëve në tenis nuk është edhe aq i komplikuar – është vetëm terminologjia ajo e cila i ngatërron shikuesit.

Anatomia e ndeshjes

Mund të argëtohem shumë mirë nëse topin vetëm e godasim pa ndonjë rregull, mirëpo nëse dëshirojmë të bëjmë gara atëherë duhet të njohim mirë sistemin e pikëve dhe terminologjinë.

Ndeshja e tenisit në veti përmban tri njësi të numërimit të pikëve

- ✓ **Pika:** Pikën e fiton ai lojtar i cili më së shumti e mban topin në fushën e lojës
- ✓ **Gem:** Duhet të fitoni më së paku katër pikë për të fituar gemin. Nëse të dy lojtarët fitojnë nga tri pikë, atëherë luhet përderisa një lojtar të fitojë dy pikë radhazi, kur luhet nga barazimi (ang. ¹deuce). Pas kësaj, loja përfundon kur lojtari i cili ka një pikë përparësi fiton edhe një pikë.
- ✓ **Set:** Lojtari i parë i cili fiton gjashtë gemat me epërsi prej dy gemave fiton setin. Ndeshja mund të luhet në tre seta (fituesi duhet të fitoj dy seta), ose në pesë seta (fituesi duhet të fitojë tre seta)

Nëse dëshironi të luani në rezultat, nuk është patjetër të luani krejt ndeshjen. Mundeni me luajt vetëm në pikë, gema ose në një set. Lojtarët serioz nuk kanë dëshirë që gjithnjë të luajnë krejt ndeshjen, pasi që kjo është garuese dhe si e tillë nuk e bënë të përshtatshme për qëllim të ushtrimit dhe relaksimit.

Fitimi i pikës

Fituesi është ai i cili fiton më shumë pikë sesa kundërshtari. Çdo pikë fillon ashtu që një lojtar shërben, kurse tjetri pranon shërbimin. Nëse topi i shërbyer kalon rrjetën godet dyshtemenë, kurse lojtari i cili pret shërbimin nuk arrin atë me kthye me goditje të reketit atëherë fitohet pika, ose as (ang. ace). Nëse topi i shërbyer bie në dyshteme, kurse kundërshtari e kthen atë në fushën e lojës mbi rrjet në hapësirën e kundërshtarit, atëherë kështu vazhdohet të luhet dhe pika zgjatë, deri sa nuk ndodh njëra nga këto

- ✓ **Topi nuk e kalon rrjetën.** Nëse topi të cilin e keni goditur, nuk e kalon rrjetën
- ✓ **Topi kalon rrjetën, mirëpo del nga fusha e lojës.** Nëse goditja e juaj shkon përtej vijave kufizuese të fushës.

¹ Deuce nga gjuha angleze që do të thotë barazim

- ✓ **Topi kalon rrjetën, bie brenda vijave kufizuese të fushës, kurse kundërshtari nuk arrin ta kthejë atë, para se topi të bie dy herë në dysheme.** Nëse topi të cilin e keni dërguar ju bie në fushën e kundërshtarit dy herë, atëherë ju fitoni pikë.

Fitim i gemit/gemave

Lojtari i parë i cili fiton katër pikë, me diferencë prej dy pikëve në dallim me kundërshtarin fiton gemin. Tingëllon thjeshtë – por shpesh këto dy pikë din të krijojnë komplikime.

Evidentimi i pikëve

Në vend se të bëhet numërimi logjik (p.sh. “zëro, dy, tri, katër” etj..), në tenis përdoret terminologjia tjetër për të përcjell se sa pikë i ka fituar lojtari gjatë ndeshjes së tenist

- ✓ **Asgjë:** Në fillim të lojës që të dy lojtarët kanë asgjë (ang. love).
- ✓ **15:** Kur fitoni një pikë, atë pikë të parë, atëherë rezultati është 15. P.sh. nëse ju shërbeni dhe fitoni pikën, rezultati do jetë 15 – asgjë (që është e njëjtë me 1:0).
është shprehur që pas çdo pike të thuhet qartë rezultati të njëjtën gjë e bënë edhe gjyqtari, pasi që kështu gjithnjë e dimë se çfarë rezultati është. Në dallim prej lojtarëve profesionist ju nuk do të keni gjyqtarin profesionist i cili do të qëndroj ulur në atë ulësen e lartë dhe të përcjell rezultatin, atëherë ju mbetet juve të bëni këtë. Është pjesë e rregullës që ai i cili e ka shërbimin të thotë rezultatin. Do të thotë, nëse ju shërbeni dhe fitoni pikë, atëherë thuani “15 – asgjë”. Nëse humbni pikën, atëherë thuani asgjë – 15. Mos e thuani menjëherë rezultatin. Kthehuni në vijën fundore, përgatituni për shërbim dhe atëherë tregoni rezultatin, para se të shërbeni.
- ✓ **30:** kur fitoni pikën e dytë, atëherë rezultati është 30. P.sh. nëse ju shërbeni dhe fitoni pikën e dytë, rezultati i ndeshjes është 30 – asgjë.
Nëse gjatë ndeshjes ju dhe kundërshtari keni numrin e njëjtë të pikëve, mundeni rezultatin të thoni me fjalë “dytë”, “dyja” ose “të gjithë” (ang. all). P.sh. nëse ju fitoni pikën e parë kurse kundërshtari të dytin, atëherë rezultati është 15 dytë. Lojtarët parapëlqejnë këtë mënyrë të kallëzimit të pikëve, pasi që kështu i shmangen fjalëve të gjata si këto:
“Pesëmbëdhjetë pesëmbëdhjetë” sidomos në ato momente kur iu mungon oksigjeni pas ngarkesës. Nëse të dy lojtarët kanë dy pikë, atëherë rezultati është 30 dytë. Kuptojeni esencën.
- ✓ **40:** kur fitoni edhe pikën e tretë, rezultati është 40. P.sh. ju shërbeni dhe i keni fituar pikën e parë, të dytën dhe të tretën, rezultati është 40 – asgjë.
- ✓ **Gem:** Nëse keni fituar edhe pikën e katërt (me diferencë prej dy pikëve), keni fituar gemin. P.sh. nëse keni fituar pikën e parë, të dytën, tretën dhe të katërtën, kurse kundërshtari i juaj asnjë pikë, atëherë rezultati është gem – asgjë.
Kurdo që lojtarit i duhet vetëm një pikë për të fituar gemin, kjo pikë quhet gem topi (ang. game point). Nëse i mungon një pikë për të fituar setin, ose ndeshjen kjo pikë quhet set topi (ang. set point) topi i ndeshjes (ang. match point). Këtë nuk duhet ta thuani, vetëm nëse qëllimi i juaj është ta nervozoni dhe frikësoni kundërshtarin.
Kur një lojtar fiton gemin, në gemin e radhës shërben lojtari tjetër.

Barazimi i mallkuar

Ngnjiher që të dy lojtarët janë aq të mirë sa asnjëri nuk mund të bënë dy pikë diference. Kur dy lojtarët kanë 40 pikë, atëherë rezultati është barazim (ang. deuce).

Kalimi në barazimin (në vend se të vazhdohet me numërimin sikurse 15, 30, 40), ka logjik, vërtet ka. Mbani në mend asnjë nga lojtarët nuk ka arritur të fitoj gemin me minimumin e katër pikëve që nevojiten dhe me diferencë prej dy pikëve. Nga ky moment lojtari duhet të fitojë dy pikë me radhë që të fitojë gemin, kurse numërimin fillon nga barazimi. Lojtarët mund të ndërrohen në fitimin e pikëve deri nesër, por asnjëri nuk mund të fitoj deri sa nuk e kalon këtë kufirin magjik prej dy pikëve radhazi. Kalimi në barazim do të thotë “OK, tash e tutje e tëra bie poshtë, krejt çka duhet është të fitojë dy pikë radhazi”.

Lojtari i parë i cili pas barazimit fiton pikën ka epërsinë (ang. advantage). Lojtari i cili ka epërsinë duhet të fitoj edhe një pikë me qëllim që të arrij epërsinë prej dy pikëve dhe kështu fiton gemin (prandaj ka epërsinë ndaj lojtarit kundërshtar).

Epërsia thuhet duke përdor “ad-in” ose “ad-out”. Nëse lojtari i cili shërben (njëkohësisht e thotë rezultatin) fiton epërsinë, atëherë është “ad-in”. Nëse lojtari i cili pranon shërbimin fiton pikën, atëherë është “ad-out”. “Epërsia ime” dhe “epërsia jote” gjithashtu përdoret.

Gjatë ndeshjeve profesionale gjyqtari shpesh thotë “epërsi Nadal”, ose “epërsi Federer”, madje në disa ndeshje të rangut të lart gjyqtaret përdorin fjalën zotëri Federer.

Nëse lojtari i cili ka epërsinë fiton pikën e radhës atëherë ka fituar, kjo është “finito”. Ky lojtar ka fituar gemin. Mirëpo lojtari i cili ka pasur epërsinë e humb pikën, atëherë përsëri vije deri tek barazimi, gjithçka shkon prej fillimit. Nëse është barazimi asnjë lojtar nuk mund të fitoj gemin, nëse fiton vetëm pikën e radhës (sikurse mundet lojtari i cili ka epërsinë).

Kur rezultati është “ad-out”, që do të thotë se kundërshtari i juaj ka epërsinë, gemin mund të fitoni vetëm nëse fitoni tri pikë radhazi. Ju duhet një pikë për të barazuar, pastaj pika për të krijuar epërsinë dhe në fund pika për të fituar krejt gemin.

Me fjalë tjera, duhet shumë të mundohemi.

Fitim i setit

Qëllimi i fitimit të gemave është që të fitohet seti. Për të fituar setin, duhet të fitoni gjashtë gema, me diferencën prej dy gemave në krahasim me kundërshtarit.

Keni fituar setin, nëse rezultati është, p.sh. 6:0, 6:4 ose 9:7.

Në tre shembuj të cekur keni fituar setin me minimum gjashtë gema dhe diferencën prej dy gemave. Për të bërë diferencën prej dy gemave në set, duhet të fitoni të paktën një gem gjatë shërbimit të kundërshtarit. Kur fitoni gemin gjatë shërbimit tuaj, atëherë mbani të drejtën e shërbimit (ang. hold serve). Kur fitoni gemin gjatë shërbimit të kundërshtarit, atëherë keni fituar brejk (ang. break). Kështu krijoni diferencën prej dy gemave.

Tajbreku i mundimshëm

Disa herë edhe pse të dy palë bëjnë përpjekje të mëdha për të fituar gjashtë gema me epërsi prej dy gemave nuk arrin me bë këtë. Kur vini deri tek pika ku të dy lojtar kanë nga gjashtë gema, luhet gëmi i veçantë cili quhet tajbrek (ang. tie-break), me qëllim që seti të mos shkoj në pafundësi. Kuptojeni këtë sikurse penaltitë në futboll – pasi që të dy lojtarë arrin gjashtë gema, atëherë luhet tajbrek, në vend se të luhen vazhdimet deri në pafundësi.

Gjatë tajbrekut, luhet seria e pikëve ku tajbrekun (setin) e fiton lojtari i cili i pari fiton shtatë pikë me epërsi prej dy pikëve. P.sh. fitoni tajbrek nëse rezultati është ky 7:0 7:5 13:11 29:27.

Gjatë tajbrekut rezultati thuhet sikurse në gëmin e rregullt. Lojtari i cili shërben e thotë rezultatin pak para se me ekzekutu shërbimin, p.sh. “4:2”, ose nëse më shumë ju pëlqen kështu “5:1 e imja” gjë e cila tregon se jeni në epërsi. Mundet edhe kështu “14 e jotja”.

Kur vije koha për këtë, shfrytëzoni rregullat në vijim deri sa luani tajbrek

1. **Lojtari i cili ka radhën të shërbejë, më fjalë tjera ai i cili duhet të shërbejë gëmin e trembëdhjetë, shërben i pari.**
2. **Pas shërbimit të parë, lojtari tjetër shërben dy pikë të radhës, të parën në pjesë fushën e majtë, të dytën në pjesë fushën e djathtë.**
3. **Pas pikës së tretë, lojtarët ndërrohen gjatë shërbimit në çdo dy pikë – edhe atë çdo herë duke filluar nga pjesë fusha e majtë.**
4. **Pas gjashtë pikëve të zhvilluara, pa marr parasysh rezultatin, lojtarët ndërrojnë anët (kjo përsëritet pas çdo gjashtë pikëve) deri sa njeri nga lojtarët fiton minimumin prej shtatë pikëve me diferencë prej dy pikëve me kundërshtarin.**

Lojtari i cili ka shërbyer gëmin e fundit para tajbrekut, shërben i pari në setin e ri. Nëse humbisni vetëm një pikë gjatë shërbimit tuaj në tajbrek, kundërshtari duhet vetëm të fitoj pikë kur shërben dhe ju keni humbur. Prandaj, mbani në mend nëse humbisni pikë gjatë shërbimit tuaj në tajbrek, është shumë e rëndësishme që menjëherë të fitoni pikë gjatë shërbimit nga kundërshtari, para se të bëhej vonë! Sidoqoftë, nga fillestarët nuk pritet që të fitojnë pikë përmes shërbimit të vet, sikurse bëjnë profesionistet.

Fundi i setave pa tajbrek

Kur dy lojtarët fitojnë nga gjashtë gema, mund të pajtoheni të mos e luani tajbrekun, por të luani përmes gemave deri sa njëri prej lojtarëve krijon epërsinë prej dy gemave.

Sot të gjithë luajnë tajbrekun.

Në lojërat zyrtare, në vend të tajbrekat e setave, setat e tjeshtë (me dy gema epërsie) luhen vetëm në këto dy raste:

✓ **Grand slem turnet** në tre prej katër Grend slem turneve, nëse të dy lojtarë fitojnë nga gjashtë gema, luhet tajbreku dhe atë në çdo set deri sa (dhe nëse) ndeshja nuk zgjatet deri të numri maksimal i setave. Çka do të thotë kjo? Kur në kongruencën e meshkujve ndeshja arrin deri tel seti i pestë, kurse në konkurrencën e femrave deri te seti i tretë. Kush do jetë fitues vendoset në setin e thjeshtë. Do të thotë, rezultati i ati seti final asnjëherë nuk është 7:6, mirëpo gjithnjë duhet të jetë me dy gema diference, p.sh. 6:4 ose 121:0.

Vetmi përjashtim është USA Open, kur në raste që lojtarët kanë nga gjashtë gema, kjo situatë zgjidhet përmes tajbrekut, madje edhe seti final – i pesti tek meshkujt, i treti tek femrat.

✓ **Devis Cup** tajbreku nuk është luajtur në Devis Cup deri në vitin 1989, kur federata ndërkombëtare e tenisit ka vendosur të aplikoj rregullat e njëjta sikurse ne Gran slem turnet. Tajbreku luhet në çdo set, përveç në ati vendimtar.

Fitim i ndeshjeve

Varësisht nga lloji i ndeshjeve që do luani, duhet të fitoni numër të ndryshëm të setave për të fituar ndeshjen.

Më i mirë në tri seta

Ndeshjet me tipike janë ato kur luhen gjithsej tre sete. Emërtimi mund të ju fus ne lajthim, pasi që këtu nuk keni nevojë ti fitoni tre sete por mundeni edhe dy, p.sh. 2:0 atëherë ju jeni fitues i ndeshjes, mirëpo kur rezultati në sete është 1:1, atëherë luajmë setin vendimtar ku mund te jetë 1:2, ose 2:1.

Më mirë në pesë sete

Në këtë ndeshje fiton lojtari i cili fiton i pari tre sete. Ndeshja mund të përfundoj shpejtë nëse lojtari fiton tre sete radhazi, mirëpo mund të ndodh të luhen edhe pesë sete. Në këso raste ndeshjet janë shumë të gjata.

Ky lloj i turneve luhet në garat me të njohura në konkurrencën e meshkujve , sikurse janë Grand Slem, Devis Cup, dhe në finale të disa turneve sikurse është ATP Tour World Championships. Në konkurrencën e femrave në pesë sete është luajtur vetëm në turnin përmbyllës WTA në New York. Të gjitha ndeshjet tjera në këtë konkurrencë luhen në tre sete.

Sistemi alternativ i numërimit të pikëve

Shumë njerëz luajnë tenis për arsye të ndryshme, dhe me intensitet të ndryshëm. Në disa raste (sikurse janë ndeshjet bamirësie, etj..) nuk është e nevojshme të luhen ndeshje të gjata. Mund të adaptohet e tëra sipas nevojës momentale. Ky lloj i numërimit të pikëve është shumë i mirë për fillestarët. Nëse nuk jeni të përgatitur mirë në aspektin fizik, ose nuk keni kohë të luani ndeshjen në tre sete, atëherë ju mund të luani një ndeshje me sistemin alternativ të numërimit ku edhe në këtë rast do të ndjeni kënaqësinë e lojës dhe të garës. Në këtë paragraf do të përmendim dy sisteme të numërimit të pikëve në të cilat më së shumti do të hasim.

Numërimi i thjeshtë

Në shumë shkolla të mesme dhe kolegje aplikohet sistemi numerik modern i numërimit pa epërsi (ang. no-ad scoring, no-advantage scoring). Numërohet pikë për pikë 0, 1, 2, 3 dhe 4. Nëse rezultati në gem është 3:3, ai i cili fiton pikën e radhës fiton edhe gemin. Gjatë rezultatit 3:3, pranuesi i shërbimit zgjedh nga cila anë do të pranon shërbimin. Gjatë këtij lloji të sistemit të numërimit, nuk ekziston barazimi ose epërsia.

Pro set

Nëse doni të luani një ndeshje të shkurtër me karakter garues, pro seti është sikurse i krijuar për juve. Pro set është një set i thjeshtë ky luhet me dy gema diferencë. Mirëpo në këtë set duhet të fitoni 8 ose 10 gema me diferencë prej dy gemave në krahasim me kundërshtarin (në vend të gjashtë gemave, si në setin e rëndomtë). Nëse rezultati është 8:8 ose 10:10, atëherë luhet tajbreku klasik me qëllim që të përcaktohet fituesi.

Si lexohet rezultati?

Kur përcillni ndeshjen në TV, gjyqtari shënon rezultatin në semafor, gem për gem. Semaforin e tregon kamera zakonisht, pak para reklamave. Numërohet sipas setave dhe gemave. Çdo kolon me numra paraqet setin dhe tregon sa ka fituar gema çdo lojtar në atë set. Nëse në semafor qëndrojnë vetëm dy kolona, atëherë ndeshja ka përfunduar pa setin e humbur (ang. straight sets).

Shembujt e paraqitjeve të rezultateve në tenis:

Lojtari	set 1	set 2	set 3
Federer	7	6	
Nadal	5	4	

foto nr. 1

Lojtari	set 1	set 2	set 3
Federer	6	6	4
Nadal	3	7	6

foto nr. 2

Në këtë ndeshje dy setat e parë i kemi ndarë, pasi që secili ka fituar nga një. Vëreni se seti i dytë ka përfunduar me rezultat 7:6. Ky rezultat na tregon se seti është kryer me tajbrek (shih foto nr. 2)

Lojtari	set 1	set 2	set 3	set 4	set 5
Federer	7 (11)	6	4	5	6
Nadal	6	4	6	7	0

foto nr. 3

Nëse loja do ishte zhvilluar në një të njërit prej turneve sikurse është Grand Slem, ku luhet përmes pesë seteve atëherë rezultati do jetë i paraqitur sikurse në foto nr. 3.

Shihni numrin 11 në kallëp, pas rezultatit në setin e parë. Kjo tregon se rezultati ka përfunduar pas tajbrekit me rezultat 13:11. Në kallëp rëndomtë shënohet numri më i vogël i gemit, pasi që në bazë të tij lehtë kuptohet sa ka qenë rezultati. Vetëm e shtoni numrin dy në atë numër dhe fitoni rezultat. Kështu shënohet me qëllim që të dihet se me çfarë rezultati lojtari ka fituar tajbrekun, nëse ka fituar tajbrekun në shtatë pikë, kjo ka mund të jetë një punë e lehtë (7:0), ose rezultat i ngushtë (7:5).

Rezultati përfundimtar është 3:2.

Literatura: McEnro Patrik dhe Bodo Peter / Tennis za Neupucene / Wiley Publishing, Inc / Përkthim nga Ilic Milos dhe Iva Cvorovic / faqe 43-52